



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. ___ Prot

Polican , me ___ . ___ . 2023

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i
gjithe kompleksit Arsimor**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV : Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare 45214220-8

Fondi limit: 100,000,000 (njqind milion) leke pa tvsh per proceduren e prokurimit me nr REF-74346-07-05-2023

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të

dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 si dhe këstin për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2023, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuesedo të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Shënim : Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

1. Vertetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
2. Kontrate Sipërmarrje;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të situacionit përfundimtarë
5. Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 42, në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera,

e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur ne rendesine e objektit te prokurimit, vleren e fondit limit te vene ne dispozion , tipologjine e punimeve te ndertimit si edhe mbeshtetur ne LPP dhe ne RRPP.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

2.3.3. Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazen e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-1 A
- NP-2 B
- NP-3 D
- NP-12 C

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS -1 A
- NS-2 A
- NS-4 A
- NS-12 A
- NS-13 A
- NS-14 A
- NS-18 B

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe

kategorite me klasifikimet perkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilin kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet në preventiv	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke.
N.P - 2 B	(Ndertime civile dhe industriale	Percaktimet në preventiv	B	E kalon vlerën 20 milion leke.
N.P – 3 C	(Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada).	Percaktimet në preventiv	C	E kalon vlerën 50 milion leke.
N.P – 12 C	(Punime të inxhinierisë së mjedisit).	Percaktimet në preventiv	C	E kalon vlerën 50 milion leke.
N.S – 1 A	(Punime për prishjen e ndërtimeve).	Percaktimet në preventive	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke.
N.S- 2 A	(Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Percaktimet në preventive	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke.
N.S.- 4 A	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Percaktimet në preventive	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke.
N.S - 12 A	(Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	Percaktimet në preventive	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke.

N.S – 14 A	- (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj).	Percaktimet preventive	ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S – 18 B	- (Punime topogjeod ezike). -	Percaktimet preventive	ne	A	e kalon vleren 20 milion leke

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **55 (pesedhjetë e pese) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve per periudhen prill 2023-qershor 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 55 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për periudhën 12 muaj, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , si dhe te figurojne ne Listpagesat e Shoqerise per Periudhen prill 2023-qershor 2023.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specififikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papaftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafhtësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

Është kërkuar inxhinier hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, kontrollin e gjithë punimeve që kanë lidhje me ndërtimin e linjave të shpërndarjes, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive të KUZ, përgjatë gjithë rrjetit etj.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, puseta shpërndarje dhe pusetat e kontrollit , breza, themele etj

Është kërkuar gjeodet/topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

Është kërkuar inxhinier mjedisi, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrit të zonës së punimeve.

Është kërkuar Inxhinier Elektrik, pasi është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të instalimeve dhe punimeve elektrike në kantier, është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij rrjeti gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, si dhe është përgjegjës për çdo problematikë në terren, në konstatimin dhe riparimin (në rast të dëmtimeve të mundshme) të çdo rasti të shfaqur gjatë punimeve në zbatimin e plotë të kontratës.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi, profili Strukturist pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet kryesisht punime strukturore sic jane punimet e mureve te reja, themeleve te reja dhe konstruksion metalik i pa;lestres, shkalle emergjence etj.

Është kërkuar inxhinier Mekanik pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Mekanike sic jane punimet e ngrohje ftohje, punime konstruksione metalike etj.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , si dhe te figurojne ne Listpagesat e Shoqerise per Periudhen prill 2023-qershor 2023.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar si më poshtë:

- Teknik Ndertimi 2 (dy)
- Teknik Topograf 1 (nje)
- Elektracist 3 (tre)
- Hidraulik 3 (tre)
- Karpentiere 3(tre)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Mekanik 1 (nje)
- Murator 3 (tre)
- Saldator 3 (tre)
- Pllakashtrues 3(tre)
- Hidroizolues 2(dy)
- Bojaxhi 3 (tre)
- Punetor/Specialist ndertimi 1 (nje)
- Manovrator 4 (tre)
- Shofer 3 (tre)
- Punonjës/specialist duralumini 2 (dy)
- Punonjës/specialist sistem ngrohje 2 (dy)
- Punonjes /Specialist Gipsi 2 (dy)
- Punonjes per Punime Guri 2 (dy)

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqerise per periudhen prill 2023-qershor 2023”, sipas Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013.

Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				

2				
3..				

-Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i liçensuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesen e shoqërisë për periudhën prill 2023-qershor 2023.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i liçensuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesen e shoqërisë për periudhën prill 2023-qershor 2023.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i liçensuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesen e shoqërisë për periudhën prill 2023-qershor 2023.

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** Inxhinier pjese e stafit te shoqerise te jete i pajisur me çertifikate “Ekspert Zjarrefikes”, leshuar nga MZSH si edhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise per periudhen prill 2023-qershor 2023.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Kontrate pune;
- b) diplome/certificate

Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar

një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse ,si dhe faturen e ketij sherbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë *për periudhën prill 2023-qershor 2023*.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë: 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë, për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a-Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (osekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshte :

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësi, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.3.9 Operatori ekonomik te disponojë ose te kete me kontrate sherbimi license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B shoqeruar me aktin e miratimit.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas, Republika e Shqipërisë, sic përcaktohet në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008.

Kjo License duhet për grumbullimin, transportimin dhe ruajtjen e mbetjeve të dale gjate punimeve të ndryshme të ndertimit.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
3	<i>Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Kamioncine me kapacitet mbajtës 1-3ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Kamion me Vinc</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Trajler per transport mjetetsh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Rimorkio për transport mjetesh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
8	<i>Fadrome me Goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
9	<i>Eskavator me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
10	<i>Eskavator me zinxhirë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Minieskavator me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Mini fadrome</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
13	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Autobeniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Autopompe betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
16	<i>Vibrator betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
17	<i>Pompa Suvatimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
18	<i>Tranxe per prerjen e kthimin e hekurit</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>

19	Skeleri	në pronësi ose me qira	Min 500 m2
20	Vinç kullë me krah jo me pak se 30 meter	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Depozite uji 1000l-5000l	në pronësi ose me qira	Copë 2
24	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Rul vibrues minimumi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
26	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
27	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Fabrikë prodhimi bordura dhe pllaka betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
30	Fabrike Prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin	në pronësi ose me qira	Copë 1
31	Impiant prodhim betoni me QKL	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti, fotot përkatëse ku të duket qarte targa;
- Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve

-Për Fabrikën e Prodhimit dyer dritare PVC dhe duralumin operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kontratë blerje të makinerisë, çertifikatat e konformitetit ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, si dhe ISO 14001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalent.

Në rastin kur fabrika është me qera ose me kontratë furnizimi, ekonomik duhet të disponoj të gjithë dokumentacionin e mësipërm si edhe kontratën noteriale të qirase ose furnizimit.

-Per Fabrikën e prodhimit bordura dhe pllaka betoni Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratë blerje te makinerive, lejen mjedisore te tipit C Kodi: III.1.A “Linje prodhimi elemente Betoni”, vertetim leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit per prodhimet sipas standartit SSHEN 1339:03, certifikatat e konformitetit ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ISO 14001:2015 "Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit" si edhe te paraqiten raportet e testimit te pllakave dhe bordurave te betonit.

Ne rastin kur fabrika eshte me kontrate furnizimi ose qiraje operatori ekonomik duhet te disponoj te gjithë dokumentacionin e mesiperm si edhe kontraten noteriale te qerase ose furnizimit.

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës ne lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit

vlërëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Sqarim lidhur me kerkesen e mjeteve te mesiperme:

- 1) *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton* , eshte i nevojshem per transportimin e materiale te krijuara nga prishja, materialet e mbushjes etj
- 2) *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton*, ky mjet vjen ne ndihme te kamionit me kap mbajtes mbi 20 ton ne menyre qe sheshi te aksesohet nga disa drejtime per te ruajtur, ndikimin ne mjedis nen normat e lejuara gjate punimeve te prishjes, transportit etj
- 3) *Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton*, ky mjet perdoret per materialet me pesha specifike me te vogel se materialet e prishjes (kryesisht betone strukture, tulla etj), gjithshu jane te domosdoshem per aksesin e tyre ne gjeresi te kufizuara ne sheshin e ndertimit
- 4) *Kamioncine me kapacitet mbajtës 1-3ton*, ky mjet eshte i domosdoshem per transportin e materialeve brenda dhe jashte kantierit te ndertimit duke rezultuar ne nje efikasitet ne kohe dhe cmim.
- 5) Autobetnierë, ky mjet eshte i nevojshem per punimet e betonit te armuar ne nevojshmeri per te kryer procesin e betonimit te panderprere per nje cilesi minimalisht te pranueshme sipas kushteve teknike te zbatimit.
- 6) Autopompe betoni, ky mjet sherben per hedhjen e betonit nga autobetonierja ne elementin strukturor ose jo te pergatitur per betonim
- 7) *Trajler per transport mjetesh, Rimorkio për transport mjetesh*, ky mjet sherben per transportimin e te gjithe makinerive me zinxhir/goma te nevojshem per punen ne sheshin e ndertimit (Minifadroma, Minieskavator etj), si dhe per heqjen e tyre nga sheshi i ndertimit per te mos penguar proceset e rradhes te punes.
- 8) Matrapik per thyerje betoni, ky mjet eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve te prishjes se ndertesave,elementeve b/a ekzistuese.
- 9) Autobot uji, eshte i nevojshem per furnizimin me uje te kantierit gjate punimeve te ndertimit, mekanike, hidraulike, shkarkimet etj.
- 10) *Kamion me Vinc* , i nevojshme per ngritjen me efikasitet te materialeve, veglave etj ne lartesi dhe levizjen e materialeve te renda ne plan per te rritur rendimentin e punes.
- 11) Minieskavator, i nevojshme per realizimin e germimeve te plintave dhe themeleve me gjeresi te vogel dhe gjithe punimet e germimit te nevojshme ne zona e ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit.
- 12) Minifadroma, i nevojshme per realizimin e levizjes se materialve te te germimit ne zona te ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit dhe per ngarkimin e tyre ne mjetet e transportit.
- 13) *Eskavator me goma* , i nevojshme per germimet e ndryshme per sheshin, per ndertimin e palestres, per punimet e germimit te muri rrethues etj
- 14) *Fadrome me Goma I nevojshem per germim dhe per shtytjen e materialeve te ndryshme te dale nga punimet e prishjes dhe punimet e germimit*
- 15) Gjeneratore, te nevojshem per furnizimin me energji elektrike gjate momenteve te mungeses se energjise nga rrjeti si dhe gjate nevojës per furnizim me energji elektike te veglave te punes ne pamundesi te lidhjes me rrjetin energjitik ekzistues.
- 16) Tranxhe hekuri, e nevojshme per realizimin e punimeve te hekurit.
- 17) Skele suvatimi, jane te nevojshme per realizimin e punimeve te suvatimit dhe veshjeve brenda dhe jashte ndertesës.
- 18) Nivelues per shtresa betoni, te nevojshme per realizimin e shtresave niveluese ne objekt dhe ne sistemimet e jashtme.

- 19) Vinxh Kulle 30m, është i nevojshëm pasi kemi punime rikonstruksioni dhe ndërtimi në objekte që shkojnë në lartësi. Meqënëse vinçi duhet të transportojë materiale në lartësi max ai duhet të jetë min mbi pikën më të lartë godines.
- 20) Greider, është i nevojshëm për punimet e nivelimit të sheshit pasi objekti në fjalë përfshin dhe sistemimin e gjithë sheshit ku do të ndërtohen rrugica, sheshe, fusha etj
- Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në procedurë të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë
 - **Hekur;**
 - **Pajisje elektrike**
 - **Pajisje hidraulike**
 - **Pajisje kondicionimi**
 - **Dyer & dritare**
 - **Materiale hidroizoluese**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.